



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:192760  
Datë: 25.04.2024  
Numri i dokumentit: 05623471

**C.nr. 1053/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.S. nga P., e përfaqësuar me autorizim nga I.D., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës KPK me seli në P. e përfaqësuar sipas autorizimit nga B.M. dhe N.T.P. “M.” me seli në S., me adresë Rruga e D., me numër të biznesit..., i përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat H.Sh., lidhur me çështjen e kompensimit të dëmit jo material dhe material, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarve të të paditurave, ndërsa me datë 25.04.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses B.S. nga P.

**II. DETYROHET** e paditura e parë KPK që paditëses në emër të kompensimit për shkak të lëndimit në punë me datë 05.03.2015, për 30% të përgjegjësisë t’ia paguaj:

a) Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore) shumën prej 540.00 €,
- Për frikë shumën prej 450.00 €,

b) Në emër të dëmit material:

- Për ndihmë të personit të tretë, shumën prej 300.00 €;
- Për ushqim të përforcuar shumën prej 151.20 €;
- Për shpenzimet e mjekimit shumën prej 83.49 €;

**III. DETYROHET** e paditura e dytë N.T.P. “M.” me seli në S., me numër të biznesit..., që paditëses në emër të kompensimit për shkak të lëndimit në punë me datë 05.03.2015, për 70% të përgjegjësisë t’ia paguaj:

a) Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore) shumën prej 1,260.00 €;
- Për frikë shumën prej 1050.00 €;

**b) Në emër të dëmit material:**

- Për ndihmë të personit të tretë, shumën prej 700.00 €;
- Për ushqim të përforcuar shumën prej 352.80 €;
- Për shpenzimet e mjekimit shumën prej 194.81 €;

**IV. DETYROHEN** e paditura e parë KPK dhe e paditura e dytë N.T.P. “M.” që shumat e gjykuara sikurse në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi t’i paguajnë me kamatë ligjore prej 8%, e cila për dëmin jo material do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me datë 25.04.2024, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë 11.05.2016, e deri në pagesën e tërësishme, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

**V. REFUZOHET E PABAZUAR** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses B.S., përtej shumave të gjykuara si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike nga shuma e gjykuar 1800.00 € e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 6500.00 €, në emër të frikës së përjetuar nga shuma e gjykuar 1500.00 € e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 6000.00 €, si dhe refuzohen në tërësi kërkesat lidhur me kompensimin e dëmit material në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese në pagesë të menjëhershme në shumën prej 500.00 €, në emër të dëmtimit të gardërobës shumën prej 120.00 € dhe në emër të rehabilitimit dhe terapisë fizioterapeutike në shumën prej 200.00 €.

**VI. DETYROHEN** të paditurat KPK dhe N.T.P. “M.” që paditëses t’i paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,026.00 €, 30% të shumës totale të shpenzimeve përkatësisht shumën prej 607.80 € të paguaj KPK dhe 70% të shumës totale të shpenzimeve përkatësisht shumën prej 1,418.20 € të paguaj N.T.P. “M.”, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor, ndërsa pjesa tjetër e kërkuar në emër të shpenzimeve procedurale në shumën prej 3,375.60 € refuzohet si e pa bazuar.

## **A r s y e t i m**

### *Paraqitja e padisë dhe pretendimet e palëve*

Paditësja B.S. nga P. e përfaqësuar me autorizim nga I.D. avokat nga Prishtina, në këtë gjykatë me datë 11.05.2016 ka paraqitur padi duke kërkuar shpërblimin e dëmit jo material dhe material, në emër të lëndimeve trupore si pasojë e rrëzimit të rafteve në vendin e punës me datë 05 mars 2015.

I autorizuari i paditëses, përmes padisë ka theksuar se e paditura e parë KPK ka arritur marrëveshje me të paditurën e dytë N.T.P. “M.” për furnizim me raftet metalike për arkivë. Këto raftet, të cilat ishin të hapura nga të gjitha anët, ishin duke u ngarkuar nga paditësja B.S. kur të njëjtat janë shembur mbi të, duke e ngujuar për një kohë, dhe si pasojë i kanë shkaktuar lëndime trupore. Më tutje, ka shtuar se raftet metalike janë produkt i të paditurës së dytë N.T.P. “M.”,

ndërsa zotëruesi i tyre është e paditura e parë KPK, duke theksuar se e paditura e parë ka dështuar në krijimin e një ambienti të sigurt për punëtorët e saj duke pas në zotërim sendin e rrezikshëm, përkatësisht raftet të cilat përbenin rrezik për mirëqenien dhe sigurinë e punëtorëve, ndërsa e paditura e dytë ka dështuar të siguroj rafte kualitative, cilësore dhe jo me defekte të cilat cilësohen si veprimtari e rrezikshme. Po ashtu, i autorizuari i paditësës përmes padisë ka theksuar se një element i rëndësishëm që vlen të përmendet është ai se raftet nuk kanë qenë të mbingarkuara, janë paluar në mënyrë normale brenda hapësirave që ka qenë e përcaktuar për vendosjen e lëndëve, pasi që rafte ka pasur të mjaftueshme që të vendosen të gjitha lëndët - element ky i cili e përjashton mundësinë e përgjegjësisë së paditësës për shkaktimin e dëmit. Për më tepër, punëtorët e arkivës - përkatësisht paditësja nuk kanë pasur ndonjë udhëzim për peshën maksimale të rafteve dhe se nga ana e punëtorëve të cilat i kanë vendosur këto rafte, u është thënë se raftet *“janë në rregull dhe mbajnë sa të duash.”* Kjo në fakt, është një domosdoshmëri të cilën e ka anashkaluar N.T.P. “M.” - duke mos dorëzuar një udhëzim për limitin e peshës të cilën do të mund ta bartnin raftet në fjalë. Sipas Vlerësimit të Rrezikut në Punën në Zyrë, vlerësim ky i vitit 2008, *“rafteve zakonisht duhet t'ju shënohet maksimumi i peshës të mjeteve që mund të ruhen në secilin raft.”* Pra, rafti duhet të ketë një shenjë të vendosur që përcakton ngarkesën maksimale të të gjithë raftit, por edhe të krahëve veç e veç, shenjë e cila ka munguar në raftet e metalta - objekt i kësaj padie. Bazuar në të lartcekurat, i autorizuari i paditësës nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësës sikurse në petitumin e saj të aprovohet si e bazuar. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor, kërkesën e padisë e ka precizuar duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësës B.S. nga P. të miratohet si e bazuar dhe të detyrohet KPK, dhe N.T.P. “M.” me seli në S., që në emër të dëmit të shkaktuar lidhur me incidentin e rrëzimit të rafteve në Prokurorinë Themelore të Kosovës, datës 05 mars 2015, t'i paguajë solidarisht paditësës: a) Për dëmin jo material: në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumë prej 6.500 €, në emër të frikës së përjetuar në shumë prej 6.000 €, b) Për dëmin material: në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 278,30 €, në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese në pagesë të menjëhershme në shumë prej 500.00 €, në emër të dëmtimit të gardërobës shumë prej 120.00 €, në emër të ndihmës së personit të tretë në shumë prej 1.000.00 €, në emër të rehabilitimit dhe terapisë fizioterapeutike shumë prej 200.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar në shumë prej 504.00 €. Ashtu që, shuma e tërësishme nga pika a) dhe b) arrin vlerën prej 15,102.30 €, me gjithë kumatën ligjore në këtë shumë, në bazë të normës së kumatës prej 8%, të kalkuluar nga data 05 mars 2015 kur është shkaktuar dëmi e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor. Kurse, në fjalën përfundimtare ka qëndruar prapa prapa precizimit të padisë dhe kërkesës së saj, duke kërkuar nga gjykata që e njëjta të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë në emër të përpilimit të parashtresave shumë prej 845.00 €, në emër të përfaqësimit në seanca gjyqësore shumë prej 2,839.20 €, në emër të mungesës nga zyra shumë prej 811.20 €, në emër të shpenzimeve të udhëtimit shumë prej 201.20 €, në emër të ekspertizave gjyqësore shumë prej 705.00 €, apo në shumë e përgjithshme prej 5,401.60 €.

E paditura e parë KPK, përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësës si të pa bazuar për nga baza juridike. Ka shtuar se, KPK dhe N.T.P. “M.” me datë 13 maj 2014,

kanë nënshkruar Kontratën Publike Kornizë me numër 03/2014 për furnizim me mobile për Prokurorinë e Shtetit. Në këtë kontratë janë përcaktuar kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit të kontratës. Më tutje ka theksuar se, me datë 05 mars 2015 kompania “M.”, ka sjellur në Prokurorinë Themelore të Prishtinës materialet e kërkuara nga KPK bazuar me specifikat e përcaktuara në kontratë. Gjatë procesit të furnizimit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës me materialet kërkuara, përkatësisht raftet e arkivës, zyrtarja e Prokurorisë, tani në cilësinë e paditëses ka filluar që në këto raftë të vendosë dokumentet e kësaj prokurorie, ku gjatë këtij procesi raftet e arkivës janë rrëzuar me ç'rast paditësja ka pësuar lëndime. Këto rrethana janë të pakontestuara nga Këshilli. Ka shtuar se, pas rrëzimit të rafteve në vendin e ngjarjes kanë dal zyrtarët e P.K. të cilët kanë mbledhur informata lidhur me këtë rast dhe me datë 19.05.2015 kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ndaj zyrtarëve A.B. dhe përfaqësuesit të Kompanisë “M.” H.M.. Prokuroria Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të të gjitha fakteve dhe provave lidhur me këtë rast me datë 08.02.2016 ka nxjerrë Shënim Zyrtar me të cilin e ka hedhur kallëzimin penal të P.K., pasi që sipas Prokurorisë nuk ka pasur element të veprës penale lidhur me këtë rast. Tutje, ka deklaruar se KPK në cilësinë e palës së parë të paditur e konteston padinë, pasi në asnjë moment nuk kemi qenë përgjegjës për materialet në këtë rast raftet e arkivës, të cilat pas rrëzimit ka pësuar paditësja. Këtë pretendim e bazojnë në kontratën nr.03/2014 përkatësisht në nenin 19 paragrafi 1, sipas të cilit: *“Furnizimet do të jenë përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm”*, ndërsa sipas nenit 21 paragraf 1 parashihet se: *“Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar”*, kurse, sipas nenit 24 përcaktohet se: *“Pas skadimit të periudhës së garancisë ose në rastet kur ka më tepër se një periudhë pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshoj Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij.”* Në referimin e të lartcekurave, si datë merret se është pranuar malli është data kur është bërë kërkesa për shlyerje të detyrimeve që sipas fakteve është data 08 korrik 2015. Ka theksuar se, duke u bazuar në aktet e nxjerra nga Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ku me datë 22 qershor 2015, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ka nxjerrë Vendim Nr.Prot.DP-086/2015 me të cilin ka themeluar Komisionin për pranimin e mallit sipas kontratës 03/2014 për furnizim me mobile për nevojat e PSH, në përbërje prej V.A., B.F. dhe A.R.. Komisioni duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatësisht në nenin 59 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik, ka qenë i obliguar që të bëjë pranimin e mallit dhe për mallin që do të pranojë të hartoj raport me shkrim. Me datë 24 qershor 2015, bazuar në dispozitat ligjore Komisioni ka hartuar raportin me shkrim për pranimin e mallit sipas specifikave të Kontratës nr.03/2014. Pasi që me datë 08 korrik 2015, është bërë kërkesa për shlyerje të detyrimeve për kompaninë “M.”, jo në sasinë fillestare që ka qenë 80 rafte po 65 rafte pasi që për raftet që janë dëmtuar në nuk kemi marrë kurrfarë përgjegjësie dhe si të tilla në nuk kemi realizuar asnjë obligim ndaj kompanisë sepse sipas kontratës ato kanë qenë në përgjegjësi të saj. Në seancat e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i autorizuar ka deklaruar se i mungon legjitimiteti real pasiv për arsye se sipas kontratës me N.T.P “M.”, të gjitha detyrimet deri në raportin përfundimtar të pranimit të rafteve bien mbi kompaninë, siç është përcaktuar me

kontratë. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka qëndruar prapa deklarimeve të thëna deri në këtë fazë, duke i propozuar gjykatës që padia dhe kërkesa e saj të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura e dytë N.T.P. "M." përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia si dhe për nga aspekti i legjitimitetit pasiv, duke shtuar se, pretendimet e paditëses se këto raftë konsiderohen sende të rrezikshme, pasi që këto raftë për nga mënyra e përdorimit dhe mënyra e vendosjes nuk paraqesin rrezikshmëri të shtuar, as për nga vetit, as për nga pozita e tyre dhe as për nga përdorimi i tyre. Pra rafti metalik nuk ka asnjë lloj vetie e cila nga vete fakti i ekzistimit të tij paraqet rrezik e aq me pak rrezik të shtuar, e gjithashtu kur rafti është i vendosur në pozitën për është i destinuar dhe përdoret në atë mënyrë i njëjti nuk paraqet rrezik të shtuar fare. Ka theksuar se, në përgjithësi edhe sendet të cilat konsiderohen si sende të rrezikshme (p.sh vetura, motosharra, vazo me lule në ballkon etj.), paraqiten si sende të rrezikshme vetëm kur ato paraqesin rrezikshmërinë e shtuar, të cilën rrezikshmëri të shtuar e krijojnë kur vihen në lëvizje. Ka shtuar se, në asnjë rrethanë as rafti i gjendur në vendin sipas destinimit nuk paraqet rrezikshmëri të shtuar. Ndërsa, në çoftë se rafti do të zhvendosej nga një vend në një vend tjetër, gjatë zhvendosjes eventualisht do të mund të krijohej rrezikshmëria e shtuar, ashtu që të konsiderohej send i rrezikshëm, e jo kur gjendet i vendosur në vend dhe atë në vendin e duhur. Tutje, ka theksuar se, e paditura e dyte ka mungesë të legjitimitetit pasiv, dhe atë nga vete fakti se e njëjta pretendon se i janë shkaktuar dëme në vend të punës. Pra, për këto lloj të dëmeve mund të mbahet përgjegjës punëdhënësi dhe jo e paditura e dytë. Po ashtu, ka theksuar se, sa i përket kualitetit të produkteve - raftëve metalike, vlen të theksohet se produktet janë të ndërtuara sipas kërkesës se të paditurës së parë. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar prapa përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë në emër të përpilimit të përgjigjes në padi dhe përfaqësimit në katër seanca shumë prej 1040.00 € dhe në emër të mungesës në zyre gjatë përfaqësimit shumë prej 260.00 €.

#### *Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar*

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: kontratën publike kornizë e datës 13.05.2014 me nr.516/14, oferta teknike e kontraktuesit e datës 14.04.2014, se bashku me përshkrimin dhe specifikat e saj, akt emërimi në emër të paditëses i datës 01.07.2015, raporti fillestari i aksidentit i datës 05.03.2015, raporti i shpejt i datës 05.03.2015, raporti i policisë mbi vendin e ngjarjes i datës 05.03.2015, fotoalbumi nga njësia e forenzikës i datës 05.03.2015, kërkesa për pushim në emër të paditëses e datës 26.03.2015, dosja e pushimit në emër të paditëses e datës 27.03.2015, raporti i ndërprerjes së përkohshme të punës në emër të paditëses, kërkesa për kompensimet e shpenzimeve të shërimit e datës 20.04.2015, procesverbali mbi intervistimin e viktimës i datës 05.03.2015, kallëzimi penal i datës 19.05.2015, raporti mbi

pranimin e mallit i lëshuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë i datës 09.03.2015, shkresa për furnizim me mobile e datës 02.07.2015, ekspertiza mjekësore e datës 10.01.2020 dhe ekspertiza për mbrojtje dhe siguri në punë e datës 08.02.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja B.S., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura e parë KPK. Po ashtu, nuk ishte kontestues fakti se paditësja në ditën kritike me datë 05.03.2015 është lënduar gjatë kryerjes së detyrave të punës. Njëkohësisht, nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse se e paditura ka pësuar lëndime trupore nga rrëzimi i rafteve.

Kontestuese në këtë çështje juridike kontestimore ishte baza juridike e kërkesëpadiës, respektivisht nëse të paditurat mbajnë përgjegjësi për kompensimin e dëmit të paditëses për shkak të lëndimit në punë.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: paditësja B.S. me datë 05.03.2015, derisa ishte në kryerjen e detyrave të punës te e paditura e parë KPK, duke i ngarkuar raftet, të cilat ishin të hapura në të gjitha anët, të njëjtit janë shembur mbi të, duke e ngujuar për një kohë, dhe si pasojë i kanë shkaktuar lëndime trupore.

Përmes Raportit të Shpejtë i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e P.K. në ditën kur ka ndodhur lëndimi në punë i paditëses me datë 05.03.2015, nga përshkrimi i këtij raporti, gjykata konstatoj se paditësja deri sa ka qenë duke punuar, paluar dosjet në rafte, raftet ishin rrëzuar dhe si pasojë të njëjtat e kanë zënë, duke rënë mbi të. Po ashtu, i njëjti raport thekson se, në vendin e ngjarjes kanë dal njësit e stacionit jugu, hetimet dhe forenzika rajonale, e po ashtu, është njoftuar edhe prokurori kujdestar, i cili ka udhëzuar që rasti të iniciohet lëndim trupor.

Nga kontrata publike kornizë për furnizim me mobileje të PSH me numër identifikues PSH 250-14-004-1.2.1, me numër të kontratës 03/2014, e datës 13.05.2014, gjykata konstatoj se e paditura e parë KPK ka lidhur kontratë për furnizim me të paditurën e dytë N.T.P. "M." me seli në S., ku pjesë e kësaj kontrate për furnizim ishin edhe raftet nga të cilat është lënduar paditësja.

Përmes Raportit të policit në vend ngjarje i titulluar si informim për rastin: lëndim trupor me numër 2015 – AD – 0701 i datës 05.03.2015, gjykata konstatoj se me datën 05.03.2015 rreth orës 15:50 policia ka dal në vend ngjarje dhe nga dëshmitaret ka konstatuar se e lënduar ka qenë paditësja B.S., e cila gjatë palimit të dosjeve në rafte të metalta, të njëjtat papritmas janë rrëzuar duke rënë mbi paditësen të cilës i kanë shkaktuar lëndime trupore.

Nga kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të shërimin e datës 20.04.2015, gjykata konstatoj se paditësja paraprakisht kishte kërkuar nga e paditura e parë KPK, përkatësisht të punëdhënësi

i saj, kompensimin e shpenzimeve të mjekimit, e po ashtu kësaj kërkesë i kishte bashkëngjitur edhe dokumentacionin mjekësor dhe faturat e shpenzimeve.

Pasi që në rastin konkret nuk ishte kontestues fakti i lëndimit të paditëses në vendin e saj të punës, me propozimin e palës paditëse me qëllim që të vërtetohen lëshimet eventuale të palëve ndërgjyqëse me rastin e lëndimit, gjykata ka nxjerrë provën me ekspertizë nga lëmia e sigurisë në punë.

Eksperti për mbrojtje dhe siguri në punë, përmes ekspertizës së hartuar me datë 08.02.202, në raport me përgjegjësinë dhe lëshimet e të paditurës së parë KPK, ka konstatuar se: Furnizimi me raftë është bërë me datë 09.03.2015 (Raporti mbi Pranimin e mallit), ndërsa komisioni me datë 24.06.2015 ka bërë verifikimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe raftet veç kanë qenë brenda objektit të së paditurës së parë dhe janë futur në funksion. Me këtë, punëdhënësi, respektivisht e paditura e parë ka dështuar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve. Ka theksuar se, punëdhënësi ka lejuar që të përdoren raftet pa u bërë pranimi teknik i tyre. Punëdhënësi nuk ka bërë vlerësim të hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës. Punëdhënësi nuk ka bërë ndonjë informim për punëmarrësin për rreziqet e punëve të cilat kryhen nga ai/ajo. Punëdhënësi nuk ka trajnuar punëmarrësin për punë në atë mënyrë e cila siguron mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tij/saj dhe e cila parandalon fatkeqësitë në punë, e po ashtu, ka theksuar se, nuk ka shënime që punëdhënësi ka informuar, organin kompetent për lëndimin në punë.

Kurse në raport me përgjegjësinë dhe lëshimet e të paditurës së dytë N.T.P “M.” eksperti për mbrojtje dhe siguri në punë ka konstatuar se: Kompania N.T.P. “M.” si furnizues ka bërë lëshime ngase ka dërguar 15 raftë me defekt, gjë që e ka konstatuar edhe komisioni nga gjithsej 80 raftë, 15 raftë nuk kanë qenë në gjendje të rregullt. Me këtë, N.T.P. “M.” nuk ka respektuar kushtet e kontratës në paragrafin 22.1 të nenit 22 të kontratës publike kornizë lidhur me obligimet për garanci. Ka theksuar se, lëshimi tjetër është se kjo kompani nuk ka dorëzuar njoftime në lidhje me peshën mbajtëse të rafteve, udhëzime lidhur me mënyrën e vendosjes së dokumentacionit dhe shpërndarjen e tyre (balancimi i peshave). E po ashtu, sipas kontratës, kompania N.T.P. “M.”, ka pasur për detyrë furnizimin, montimin dhe transportin e mjeteve (Pjesa III e Kontratës, Kushtet e Veçanta, Pika 19 Dorëzimi), ku si pasoj e mos montimit të mirë ka ndodhur aksidenti në punë.

Ndërsa, në vlerësimin përfundimtar profesional, eksperti për mbrojtje dhe siguri në punë ka arritur në përfundim se, duke pasur parasysh nivelin e përgjegjësisë dhe rrethanat e krijuara që kanë shpie në lëndimin e paditëses B.S. nga P., bazuar në dëshmitë e prezantuara në dosje, analizës së hollësishme të tyre, ka konstatuar se përgjegjësia kryesore për lëndimin e punëtores bie mbi të paditurën e dytë (Kompaninë N.T.P. “M.”), por një përgjegjësi bie edhe mbi të paditurën e parë (KPK), me lëshimet e bëra të cilat janë specifikuar në pikat a) dhe b) në kuadër të konstatimeve të ekspertit.

Eksperti, gjatë deklaramentit të tij në seancën e shqyrtimit kryesor ka sqaruar se në bazë të kontratës operatori ekonomik, në këtë rast e paditura e dytë, e ka pas për detyrë të bëjë furnizimin,

montimin dhe transportin e mjeteve, dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës edhe komisioni i pranimit ka konstatuar se 15 raftete nuk kanë qenë në gjendje të rregullt. Më tutje, ka shtuar se nga përvoja e tij profesionale, një rënie e tillë e rafteve, zakonisht ndodh për shkak të mos montimit të mirë dhe përforcimit të tyre.

Me qëllim të konstatimit të shkallës së lëndimeve trupore, e po ashtu për të vlerësuar frikën e paditëses si pasojë e lëndimeve, gjykata sipas propozimit të paditëses, ka nxjerr provat përmes ekspertizave mjekësore dhe atë nga eksperti mjekësor ortoped - traumatolog Dr. V.B. dhe eksperti mjekësor neuropsikiatër Dr. F.D.. Ekspertët mjekësor, përmes ekspertizës së datës 10.01.2020 kanë konstatuar se paditësja, si pasojë e lëndimit në punë me datën 05.03.2015 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të krahut të djathtë, ndrydhje të qafës dhe ndrydhje të shpinës, e të cilat lëndime kategorizohen si lëndime të lehta trupore.

Sipas ekspertizës mjekësore të datës 10.01.2020, Dr. V.B., në bazë të ekzaminimit të drejtpërdrejtë mjekësor të datës 10.01.2020, si dhe analizimit të dokumentacionit mjekësor që gjendet në shkresa të lëndës, dhe atë: Raporti i lëshuar nga QKMF me nr. 29 i datës 06.03.2015, Qendra e Mjekësisë Urgjente nga QKUK i datës 08.03.2015 dhe datës 11.03.2015, 2.03.2015 dhe 11.04.2015, fotografitë e krahut dhe RM të pjesës cervikale dhe krahut të djathtë i datës 08.03.2015, paditësja ka pasur: dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë, të cilat kanë zgjatur prej 15 minuta sa ka qëndruar e shtypur nga raftet e shembura mbi të, me intensitet të rëndë 4 ditë, kohe pas kohe deri në veprimin e terapisë ordinar kundër dhimbjes si pasojë e ndrydhjeve të marra në regjionin e qafës, shpinës dhe krahut të djathtë, me intensitet të mesëm 30 dite, koha e nevojshme për tërheqjen e edemës dhe hematomave në regjionet e ndrydhura, inflamacioneve post traumatike nën veprimin e terapisë, si dhe kohe e nevojshme për rehabilitimin e indeve të lënduara të regjionit të qafës shpinës dhe krahut të djathtë, me intensitet të ulët që kanë zgjatur intenzivisht edhe për 8 javë e sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësen këto dhimbje janë prezentë edhe sot e kësaj dite, me të shprehura gjate sforcimeve fizike sidomos ngritjes së peshës në dorën e djathtë.

Sa i përket frikës, në bazë të mendimit profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore të datës 10.01.2020, Dr. F.D. neuropsikiatër, gjykata vërtetoi faktet se gjatë lëndimit në punë paditësja ka përjetuar frikë primare, e cila ka zgjatur 7 deri në 8 minuta. Frikë sekondare e intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 5 orë, frikë sekondare e intensitetit mesatar e cila ka zgjatur 3 muaj dhe frikë sekondare e intensitetit të ulët e cila ka zgjatur 3 muaj.

Ekspertët kanë konstatuar se paditësja nuk ka pësuar shëmtim trupor, e as zvogëlim të aktivitetit jetësor. Po ashtu, ekspertët kanë konstatuar se paditësja kishte zvogëlim të aktivitetit punues, i cili ka qenë për 2 muaj 100% për shkak të hematomave dhe edemës në krahun e djathtë regjionin e qafës dhe shpinës, ndërsa edhe për 3 muaj ka pasur zvogëlim të aktivitetit punues për 50%, pasi ka pasur vështirësi në ngritje të dorës dhe mbajtje të peshës. Pas asaj kohe ka qenë e aftë për punë. Ndërsa, gjithnjë sipas ekspertëve, ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 jave, sa ka pasur vështirësi në ngritje të krahut të djathtë si pasojë e edemës dhe hematomave si dhe vështirësi në lëvizje si pasojë e ndrydhjes së shpinës dhe qafës dhe atë ndihmë në veshmbathje, higjienë personale dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore.



Kurse, kishte nevojë për ushqim të përforcuar për 12 javë, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina si dhe ka qenë i nevojshëm rehabilitimi fiziko – terapeutik në vitin e parë pas aksidentit për 14 ditë dhe 14 ditë në vitin e dytë, për forcim të muskujve të regjionit të krahut të djathtë qafës dhe shpinës. Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, në seanca gjyqësore pasi që kanë deklaruar se ekspertizat mjekësore i kanë pranuar me kohë, të njëjtit nuk kanë paraqitur vërejtje në këto ekspertiza, e po ashtu nuk kanë kërkuar që ekspertet të ftohën për të dhënë sqarime në seancën e shqyrtimit kryesor. Të njëjtat ekspertiza, gjykata i vlerësoj si profesionale dhe të hartuara në përputhje me detyrat e përcaktuara paraprakisht nga gjykata.

### *Baza ligjore*

Bazuar në faktet e lartcekura, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD), e po ashtu, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me lëndim në punë, gjykata vlerëson se duhet të zbatohen edhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Bazat e përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, përcaktohen me nenin 136 të LMD-së, ku paragrafi 1 i këtij neni parasheh se: *“1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Nga përmbajtja e këtij paragrafi rrjedh se kush i shkakton dëm tjetrit, ka detyrimin t’ia kompensojë përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Pra, për përgjegjësinë mbi bazën e fajësisë, sipas kësaj dispozite, varet nga raporti subjektiv i shkaktuesit të dëmit me dëmin e shkaktuar.

Ndërsa, me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.”* Me këtë dispozitë është parashikuar përgjegjësia objektive për shpërblimin e dëmit pavarësisht nga faji, në rastet kur dëmi është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme. Më tutje, në raport me përgjegjësinë objektive sipas sendit apo veprimtarisë së rrezikshme, LMD parasheh dispozita të veçanta nga neni 154 deri tek neni 158.

Ndërsa, përveç përgjegjësisë objektive sipas kategorisë së sendeve apo veprimtarive të rrezikshme, me paragrafin 3 të nenit të lartcekur, parashihet se: *“Për dëmin pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.”* Në lidhshmëri me këtë dispozitë, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në nenin 6 paragraf 3 parasheh se: *“Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.”*

Më tutje, me nenin 60 paragraf 1 të Ligjit të Punës parashihet se: *“Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, të ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera të aplikueshme.”*

Ndërsa, neni 5 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton se: “1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. 2. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore. 3. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës.” Në lidhshmëri me këtë, neni 6 paragrafi i ligjit të lartcekur përcakton: “Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.”

Kurse, në nenin 18 paragraf 1 Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, parasheh obligimin e punëdhënësve, për të informuar të punësuarit, duke përcaktuar se: “1. Punëdhënësi merr masa adekuate që të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre të marrin të gjitha informatat e nevojshme lidhur me: 1.1. çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese si dhe aktivitetet që i ndërmerrë nga ana e tij për eliminimin e këtyre rreziqeve; 1.2. informimin e të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre për ndihmën e parë, masat në rast zjarri, evakuimin, si dhe përgjegjësitë e veçanta të secilit për marrjen e këtyre masave; 1.3. vlerësimin e rrezikut, si dhe masat e ndërmarrja për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen në punë për të punësuarit, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gji dhe personat me aftësi të kufizuara.”

#### *Vlerësimi i gjykatës*

Pas administrimit, analizimit dhe vlerësimit të provave në raport me dispozitat ligjore, gjykata arriti në përfundim se të paditurat mbajnë përgjegjësi për kompensimin e paditëses, të njëjtat duhet të përgjigjen mbi bazën e përgjegjësisë objektive dhe subjektive, në këtë rast e paditura e parë mban përgjegjësi objektive, ndërsa e paditura e dytë bartë përgjegjësi subjektive.

Nga provat e administruara, gjykata konstatoj se paditësja B.S. me datë 05.03.2015, derisa ishte duke i kryer detyrat e punës te e paditura e parë KPK, përkatësisht duke paluar dosje në rafte, të njëjtat rafte rrezohen mbi të, duke e zënë për një kohë, me ç’rast pëson lëndime të lehta trupore.

Gjykata vlerëson se e paditura e parë KPK, me rastin e lëndimit të punëtorit në punë, duhet të përgjigjet sipas përgjegjësisë objektive, e përcaktuar me nenin 136 paragraf 3 të LMD-së, pavarësisht fajit. Gjykata rithekson se kur bëhet fjalë për rastet e posaçme të përgjegjësisë objektive të përcaktuara sipas nenit 60 paragraf 1 të Ligjit të Punës dhe me nenin 6 paragraf 3 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, siç janë lëndimet në punë, sëmundjet profesionale apo sëmundjet në lidhje me punën, përgjegjësia bie mbi punëdhënësin, pavarësisht fajit.

Për me shumë, e paditura e parë nuk ka prezantuar asnjë provë para gjykatës lidhur me detyrimet e saj që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Në lidhshmëri me këtë, gjykata rithekson se e paditura e parë në cilësi të punëdhënësit kishte për detyrim ofrimin e informatave, trajnimeve dhe udhëzimeve siç përcaktohet me nenin 6 paragraf 1 të Ligjit të lartcekur, po ashtu kishte për detyrim të ndërmarr veprime për të garantuar zbatimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë siç përcaktohet me nenin 13 paragraf 1 nën-

paragraf 1.2., 1.3. dhe 1.4. të Ligjit të lartcekur, e po ashtu kishte për obligim të vë në dispozicion të punësuarve udhëzimet e hollësishme, në zbatimin e dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, për çdo vend pune, i dokumentuar nëpërmjet një procesverbali, ashtu siç përcaktohet me nenin 18 paragraf 3 të të njëjtit ligj.

Ndërsa, në raport me përgjegjësinë e të paditurës së dytë N.T.P. "M." duke marr për bazë se e njëjta ka qenë përgjegjëse për furnizimin dhe montimin e rafteve, si pasojë e të cilave paditësja është lënduar, gjykata vlerëson se e njëjta është përgjegjëse sipas nenit 136 paragraf 1 të theksuar me lartë, dhe e njëjta është përgjegjëse sipas fajtit. Kjo për faktin se, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit për mbrojtje dhe siguri në punë, e cila lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë ishte provë vendimtare, gjykata konstatoj se deri te lëndimi i paditëses ka ardhur me fajin e të paditurës së dytë N.T.P. "M." dhe se përgjegjësia kryesore për lëndimin e të paditurës bie mbi të. Në lidhshmëri me këtë, eksperti ka konstatuar se si furnizues i padituri i dytë N.T.P. "M." ka bërë lëshime ngase ka dërguar 15 rafte me defekt, gjë që e ka konstatuar edhe komisioni nga gjithsej 80 rafte, 15 rafte nuk kanë qenë në gjendje të rregullt. Ka theksuar se, lëshimi tjetër është se kjo kompani nuk ka dorëzuar njoftime në lidhje me peshën mbajtëse të rafteve, udhëzime lidhur me mënyrën e vendosjes së dokumentacionit dhe shpërndarjen e tyre (balancimi i peshave). E po ashtu, sipas kontratës, kompania N.T.P. "M.", ka pasur për detyrë furnizimin, montimin dhe transportin e mjeteve, ku si pasojë e mos montimit të mirë ka ndodhur aksidenti në punë.

Gjykata ekspertizën e ekspertit gjyqësor për siguri dhe mbrojtje në punë, e konsideroj si profesionale, me përfundime të qarta, dhe e hartuar mbi bazën e rregullave të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Për me shumë, në raport me përgjegjësinë e të paditurës së dytë gjykata e analizoj dhe vlerësoj edhe kontratën për furnizim me rafte e lidhur në mes të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë, dhe nga e njëjta konstatoj se e paditura e dytë kishte për obligim të garantojë që asnjë nga furnizimit të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria, e njëkohësisht sipas kësaj kontrate e paditura e dytë ka qenë përgjegjëse për mënjanimin e defekteve ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqitën. Lidhur me këtë, në nenin 19 paragraf 1 të kësaj kontrate parashihet se: *"Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm"*, ndërsa sipas nenit 21 paragraf 1 të po kësaj kontrate përcaktohet se: *"Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar."* Më tutje, lidhur me këtë gjykata e vlerësoj Raportin mbi pranimin e mallit i lëshuar nga e paditura e parë i datës 09.03.2015, nga i cili konstatoj se komisioni për pranimin e mallit, përkatësisht rafteve, me rastin e verifikimit të rafteve, nëse të njëjtat janë konform specifikacioneve dhe kushteve të kontratës, komisioni ka konstatuar se nga numri 80 i rafteve i cili ishte pranuar, 15 prej tyre janë jashtë përdorimit për shkak se janë të dëmtuara. Ndërsa, në raport me këto rafte të dëmtuara, gjykata konstatoj se të njëjtat nuk janë paguar nga e paditura e parë, përkatësisht e njëjta nuk ka marr përgjegjësi për dëmtimin e tyre, dhe këtë fakt gjykata e konstatoj përmes kërkesës për shlyerjen e detyrimeve për kompaninë N.T.P. "M." e lëshuar nga e paditura e parë me datë 08.07.2015.

Rrjedhimisht, me vet faktin se paditësja është lënduar në punë, gjatë kryerjes së detyrave të punës, pa qenë e ndikuar nga veprimet e kundërligjshme të saj apo e shtyrë nga ndonjë faktor tjetër subjektiv, nënkupton përgjegjësinë e të paditurave për dëmin e shkaktuar. Në rastin konkret, gjykata në raport me përgjegjësinë e të paditurës së parë është mjaftuar me vërtetimin e faktit se pasoja - lëndimi i paditëses, ka ndodhur derisa ishte duke i kryer detyrat e punës, për llogari të punëdhënësit, si fakt vendimtar për përcaktimin e përgjegjësisë objektive, ndërsa në raport me përgjegjësinë e të paditurës së dytë, gjykata në mënyrë të mjaftueshme ka arritur të konstatoj përgjegjësinë sipas fajit, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë, gjykata ka krijuar lidhjen kauzale, duke qenë se paditësja me asnjë veprim të saj, qoftë në kundërshtim me rregullat e punës apo me kontributin e tij, nuk rezulton se ka kontribuar në shkaktimin e lëndimit. Në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerëson se lidhja kauzale është një ndër kushtet për lindjen e përgjegjësisë lidhur me dëmin e shkaktuar.

Në raport me ndarjen e përgjegjësisë për të paditurën e parë dhe të dytë, gjykata mori parasysh kontributin e tyre në shkaktimin e dëmit. Bazuar në këtë, vendosi të ndajë përgjegjësinë në shkallën 30% për të paditurën e parë dhe 70% të paditurën e dytë, dhe atë duke u bazuar në ekspertizën për mbrojtje dhe siguri në punë, e cila mbi bazën e dëshmive të prezantuara në shkresa të lëndës dhe analizës së hollësishme të tyre, ka konstatuar se përgjegjësia kryesore për lëndimin e punëtores bie mbi të paditurën e dytë N.T.P. "M.", por njëkohësisht një pjesë e përgjegjësisë bie edhe mbi të paditurën e parë KPK.

Ndërsa, edhe pse në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se ka ndodhur pasoja në kohën dhe vendin e caktuar, gjykata këtë rrethanë e ka vërtetuar edhe mbi bazën e Raportit të Shpejtë i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e P.K. në ditën kur ka ndodhur lëndimi në punë i paditëses me datë 05.03.2015, e po ashtu edhe nga Raporti i Policisë në vend ngjarje, i titulluar si informim për rastin: lëndim trupor i të njëjtës datë kur ka ndodhur lëndimi, për çka këto raporte për gjykatën ishin prova të pranueshme, sepse të njëjtat e kanë cilësinë e dokumenteve publike apo zyrtare.

Njëkohësisht, gjykata i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës së parë KPK dhe të paditurës së dytë N.T.P. "M.", lidhur me kundërshtimin e padisë dhe kërkesës së saj, mirëpo të njëjtat i konsideroj si të pa bazuara. Në raport me pretendimet e të paditurës së parë se e njëjta nuk është e legjitimuar në këtë procedurë dhe rrjedhimisht nuk mund të bartë përgjegjësi, gjykata vlerësoj se një pretendim i tillë është i pa qëndrueshëm. Kjo për faktin se e paditura e parë, duke qenë në cilësi të punëdhënësit dhe lëndimi i paditëses në vendin e punës, pa fajin apo veprimin e saj në shkaktimin e dëmit e vërteton lidhjen kauzale në mes të shkakut dhe pasojës.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve të paditurës së dytë N.T.P. "M." se e njëjta ka mungesë të legjitimitet pasiv, dhe atë nga fakti se paditësja pretendon se i janë shkaktuar dëme në vend të punës dhe se për këtë lloj të dëmeve mund të mbahet përgjegjës punëdhënësi dhe jo e paditura e dytë, e po ashtu pretendimit lidhur me kualitetin e produkteve - rafteve metalike, e cila pretendon se të njëjtat kanë qenë të ndërtuara sipas kërkesës se të paditurës së parë. Gjukata në raport me këto pretendime, vlerësoj se të njëjtat janë të pa bazuara, për faktin se siç është konstatuar më lartë e paditura e dytë e bartë përgjegjësinë kryesore në raport me dëmin e shkaktuar, dhe e njëjta është përgjegjëse sipas fajit, përkatësisht përgjegjësisë subjektive, për çka gjykata në këtë

përfundim ka arritur në bazë të ekspertizës së hartuar nga eksperti gjyqësor për mbrojtje dhe siguri në punë, e cila ekspertizë për gjykatën ishte provë vendimtare. Kurse, në anën tjetër, para gjykatës nuk ka prezantuar asnjë provë e cila eventualisht do të konstatonte të kundërtën e asaj të vërtetuar si më lartë. E në lidhshmëri me këtë, LPK-ja në nenin 7 paragraf 2 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, e po ashtu, edhe në nenin 319 paragraf 1 të të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Mbi këtë bazë, gjykata i konsideroj si të pa argumentuara dhe të pa bazuara pretendimet e të paditurave.

#### *Vlerësimi i dëmit dhe lartësisë së kërkesëpadisë*

Në raport me lartësinë e kompensimit të dëmit jo material, me paragrafin 1 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.”* Bazuar në këtë dispozitë dhe në nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e duke u bazuar edhe në ekspertizat mjekësore, gjykata vendosi lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket kompensimit në emër të dhimbjeve fizike dhe në emër të frikës së përjetuar, duke marr parasysh faktin se kompensimi i dëmit jo material konsiderohet si satisfaksion për të dëmtuarën, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasoj e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditëses.

Për dhimbjet fizike, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1.800.00 €, si shpërblim të drejtë që i shërben qëllimit të shpërblimit, në pajtim me mendimin e ekspertëve, pasi që ekspertët kanë vlerësuar se paditësja ka pësuar lëndime të cilat kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Në raport me këtë, mbi bazën e ndarjes së përgjegjësisë, gjykata vendosi që e paditura e parë KPK për 30% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 540.00 €, ndërsa e paditura e dytë N.T.P. “M.” për 70% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 1260.00 €.

Ndërsa, për frikën e përjetuar gjykata vlerësoj se shuma prej 1,500.00 € është shumë adekuate dhe e drejtë, duke marrë parasysh intensitetin e frikës së përjetuar, të cilën gjykata e ka bazuar në mendimin e ekspertit mjekësor neuropsikiatër Dr. F.D.. Lidhur me ndarjen e shumave, gjykata të njëjtën e bëri mbi bazën e ndarjes së përgjegjësisë, duke vendosur që e paditura e parë KPK për 30% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 450.00 €, ndërsa e paditura e dytë N.T.P. “M.” për 70% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 1050.00 €.

Kurse, sipas ekspertizës së lartcekur mjekësore nga lëmia ortopedike - traumatolog përkujdesja nga personi tjetër për paditësen ka qenë i nevojshëm për 10 javë. Bazuar në këtë konstatim të ekspertit, gjykata vlerësoj se shuma e kërkuar nga paditësja në lartësi prej 1,000.00-€ është në përputhje me vlerën e cila i takon paditëses në emër të përkujdesjes nga personat e tretë, për çka vendosi që e njëjta të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për të njëjtën shumë, gjykata vendosi të ndaj mbi bazën e përgjegjësisë, duke vendosur që e paditura e parë KPK për 30 % të

përgjegjësisë të paguaj shumën prej 300.00 €, ndërsa e paditura e dytë N.T.P. “M.” për 70% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 700.00 €.

Në raport me njohjen e së drejtës për ushqim të përforcuar për 12 javë, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, për forcim të muskujve të regjionit të krahut të djathtë qafës dhe shpinës, bazuar në këtë konstatim të ekspertit, gjykata vlerësoj se shumata e kërkuar nga paditësja në lartësi prej 504.00.-€ është në përputhje me nevojat e paditëses në emër të ushqimit të përforcuar, për çka vendosi që e njëjta të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për të njëjtën gjykata vendosi që të detyrohen të paditurat të paguajnë mbi bazën e përgjegjësisë dhe atë e paditura e parë KPK për 30% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 151.20 €, ndërsa e paditura e dytë N.T.P. “M.” për 70% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 352.80 €.

Sa i përket shpenzimeve të mjekimit, gjykata për të njëjtat vendosi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, mbi bazën e provave të cilat gjenden në shkresa të lëndës të bashkëngjitura kërkesës për kompensimin e shpenzimeve, përmes së cilës kërkesë paditësja kishte kërkuar nga e paditura e parë kompensimin e shpenzimeve të mjekimit si pasojë e lëndimit në punë, e nga të cilat konstatohet se paditësja ka realizuar vizita mjekësore si pasojë e lëndimeve të pësuar, e nga të cilat vizita ka shpenzuar shumën prej 278.30 €. Siç u theksua edhe me lartë, ndarjen e shumave gjykata e bëri mbi bazën e përgjegjësisë, duke vendosur që e paditura e parë KPK për 30% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 83.49 €, ndërsa e paditura e dytë N.T.P. “M.” për 70% të përgjegjësisë të paguaj shumën prej 194.81 €.

### *Pjesa refuzuese*

Lidhur me pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, për pjesën e refuzuar, sa i përket dëmit jo material, gjykata vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, duke marr për bazë natyrën e lëndimeve të paditëses dhe frikën e përjetuar, për çka vendosi që të njëjtat të refuzohen.

Sa i përket kërkesës së paraqitur nga paditësja në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese, në pagesë të menjëhershme në shumën prej 500.00 €, gjykata vlerësoj se një kërkesë e tillë është e pa bazuar. Lidhur me këtë, neni 179 paragraf 2 i LMD-së parasheh: *“Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t'i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.”* Gjykata vlerëson se kjo dispozitë zbatohet në rastet kur i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë, e humb fitimin të cilin do të realizonte sikurse të mos kishte ndodhur lëndimi. Ndërsa, në rastin konkret, bazuar në akt emërimin e lëshuar nga e paditura e parë në emër të paditëses i datës 01.07.2015, kërkesa për pushim në emër të paditëses e datës 26.03.2015, dosja e pushimit në emër të paditëses e datës 27.03.2015, gjykata konstatohet se paditësja ishte e punësuar te e paditura e parë pa afat të caktuar, dhe gjatë kohës së shërimit e njëjta e kishte shfrytëzuar të drejtën e pushimit, dhe rrjedhimisht i ka shfrytëzuar të drejtat të cilat përcaktohet me legjislacionin nga e drejta e punës. Në këtë përfundim gjykata arriti duke u bazuar edhe në ekspertizën e eksperteve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësja kishte zvogëlim të aktivitetit punues, i cili ka qenë për 2 muaj 100% për

shkak të hematomeve dhe edemës në krahun e djathtë regjionin e qafës dhe shpinës, ndërsa edhe për 3 muaj ka pasur zvogëlim të aktivitetit punues për 50%, pasi ka pasur vështirësi në ngritje të dorës dhe mbajtje të peshës, ndërsa pas asaj kohe ka qenë e aftë për punë.

Kurse, në raport me kërkesat e tjera për kompensim të dëmit material dhe atë në emër të dëmtimit të gardërobës shumën prej 120.00 € dhe në emër të rehabilitimit dhe terapisë fizioterapeutike shumën prej 200.00 €, gjykata të njëjtat i refuzoj si të pa bazuara, kjo për faktin se paditësja të njëjtat nuk ka i ka argumentuar me prova materiale. Gjukata nuk e përjashton mundësin që paditësja të ketë krijuar shpenzime eventuale për nevoja të shërimit, mirëpo për të njëjtat nuk ka ofruar prova para gjykatës. Lidhur me këtë, LPK-ja në paragrafin 2 të nenit 7 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* Për më shumë, në raport me kërkesën në emër të rehabilitimit dhe terapisë fizioterapeutike, gjykata i kishte parasysh konstatimet e eksperteve mjekësor, mirëpo gjykata vlerëson se nuk mjafton që vetëm të ketë konstatim të ekspertit mjekësor për nevojën e trajtimit, por duhet të sigurohen prova përkatëse se paditësja ka pasur një shërim të tillë, dhe në rast se kishte cilat shpenzime janë krijuar, gjë që në këtë rast nuk është dëshmuar me asnjë provë.

Gjukata ka vlerësuar dhe administruar edhe prova të tjera, mirëpo, të njëjtat nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese.

#### *E drejta e kamatës*

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoj në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Për dëmin jo material gjykata e njohu të drejtën në kamatë nga momenti i përpilimit të aktgjykimit me datë 25.04.2024. Kjo për faktin se pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatën, nga momenti kur ka kuptuar për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar. Ndërsa, për dëmin material, kamatën e njohu nga momenti i paraqitjes së padisë me datë 11.05.2016.

#### *Shpenzimet e procedurës*

Vendimin që palët e paditura t'i bartin shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse në këtë procedurë, si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe atë 30% të shumës totale të shpenzimeve të procedurës kontestimore përkatësisht shumën prej 607.80 € t'i paguaj e paditura e parë KPK dhe 70% të shumës totale të shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 1,418.20 € t'i paguaj e paditura e dytë N.T.P. “M.”, me seli në S..

Lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohet shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 156.00 €, për parashtrësë për

precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 156.00 €, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 100.00 €, për dy ekspertiza mjekësore secila nga 150.00 €, shumë prej 300.00 €, për dy ekspertiza nga mbrojtja dhe siguria në punë secila nga 150.00 € shumë prej 300.00 €, për pesë seanca të mbajtura për secilën nga 202.80 € shumë prej 1014.00 €, e në shumë e përgjithshme prej 2026.00 €.

Ndërsa, pjesën tjetër të shpenzimeve procedurale, gjykata i ka refuzuar si të pa bazuara duke u mbështetur në nenin 453 të LPK-së, sipas të cilit: *“453.1 Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumë e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. 453.2 Po që se është parashikuar tarifa për shpërblimin e avokatëve, apo për shpenzimet tjera, atëherë këto shpenzime do të matën sipas tarifës së tillë.”* Shpenzimet e refuzuara i referohen kërkesës në emër të përfaqësimit në seanca gjyqësore në shumë prej 1,825.00 €, kërkesës për shpenzimet në emër të përpilimit të parashtrësive në shumë prej 533.00 €, kërkesës për shpenzimet në emër të mungesës nga zyra në shumë prej 811.20 € dhe kërkesës në emër të shpenzimeve të udhëtimit në shumë prej 201.20 €, e në shumë e përgjithshme prej 3,375.60 €.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr. 1053/2016, datë 25.04.2024**

**Gjyqtari**  
Argzon Muçaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.